



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

---

Numri i lëndës: 2022:014866

Datë: 30.04.2024

Numri i dokumentit: 05644088

A. nr.165/2022

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, Departamenti për Çështje Administrative, me gjyqtaren: Luljeta Maxhuni, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit, R.J. nga fshati ...- Komuna e ... kundër të paditurës, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve në Prishtinë, për shkak të “heshtjes administrative”, jashtë seancës gjyqësore më datë 30.04.2024 mori këtë:

A K T V E N D I M

Pezullohet procedura sipas padisë së paditësit, R.J. nga fshati ..., e ushtruar në këtë çështje juridike me datë 25.01.2022 e evidentuar me numër A.nr.165/2022.

A r s y e t i m i

Paditësi, ka ushtruar padi në këtë gjykatë, më datën 25.01.2022, kundër të paditurës Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve në Prishtinë, me të cilën ka kërkuar nga Gjykata “që të aprovohet në tërësi si e bazuar padia e paditësit dhe të urdhërohet organi i paditur të nxjerr aktin administrativ në kuptim të aprovimit të kërkesës së paditësit për njohjen e të drejtës në kompensimin e personave paraplegjik dhe tetraplegjik”.

Gjykata lidhur me këtë padi me numër të lëndës A.nr.165/2022 me datë 15.02.2024 ka mbajtur seancën përgatitore ku të pranishëm nuk ishin palët ndërgjyqëse, edhe pse të ftuar në mënyrë të rregullt gjyqësore (Provë: për paditësin flete kthesa e datës 30.01.2024 dhe për të paditurën flete kthesa e datës 29.01.2024), ku në këtë seancë gjykata ka vërejtur se nga përgjigja në padi tani më nuk ka heshtje administrative, mirëpo e paditura ka nxjerrë vendimin e mëvonshëm të datës 23.11.2021 (me të cilin vendim është refuzuar ankesa e paditësit për kompensimin për personat paraplegjik dhe tetraplegjik, për arsye se nuk janë plotësuar kushtet ligjore), vendim ky i nxjerrë pas Aktgjykimit me numër A.nr.29/19 të datës 21.07.2021.

Lidhur me këtë gjykata, në seancën e shqyrtimit gjyqësor, bazuar në nenin 36 të LKA-së, ka marr aktvendim, ku ka ftuar paditësin që brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh të deklarohet nëse me aktin administrativ të nxjerrë në afatin e mëvonshëm: jeni të kënaqur; nuk hiqni dorë nga padia; pjesërisht hiqni dorë nga padia; padinë e zgjeroni edhe në aktin tjetër; II. Nëse paditësi, deklaron se me aktin e nxjerrë në afatin e mëvonshëm është i kënaqur apo nëse nuk e jep deklaratën brenda afatit të lart cekur gjykata do të nxjerrë vendimin mbi pezullimin e procedurës. III. Ndërsa nëse paditësi deklaron se me aktin e ri nuk është i kënaqur, gjykata do ta vazhdojë procedurën.

Më tutje, gjykata vërejt se paditësi, ..., procesverbalin e datës 15.02.2024 e ka pranuar në mënyrë të rregullt, fakt i cili vërtetohet nga fletë kthesa e datës 04.03.2024, mirëpo i njëjti nuk ka vepruar sipas udhëzimeve të gjykatës.

Megjithatë paditësi, në afatin e përcaktuar prej 15 ditësh, nuk është deklaruar lidhur me aktin e nxjerrë në afatin e mëvonshëm, gjykata në kuptim të Nenit 36.1.2.3 të Ligjit Nr.03/L-202, për Konfliktet Administrative (LKA), e pezullon padinë dhe ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË**  
**DEPARTAMENTI PËR ÇËSHTJE ADMINISTRATIVE**  
A.nr.165/2022 më datë 30.04.2024

Gjyqtare  
Luljeta Maxhuni

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 dite, nga dita e marrjes së të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.